



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr 7013 Prot.

Tiranë, më 16/10 /2024

NJOFTIM

Drejtuar: Autoriteteve/enteve kontraktore

Operatorëve ekonomikë

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”), njofton të gjithë palët e interesuara se, për t’i ardhur në ndihmë autoriteteve dhe enteve kontraktore, me mbështetjen e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ka përkthyer në gjuhën angleze setet e miratuara të Dokumentave Standarte të Tenderit, për mallra, punë, shërbime, për procedurat e prokurimit “Tender i Hapur” dhe “Tender i Kufizuar”.

Setet e përkthyera të dokumentave standarte të tenderit, për këto procedura prokurimi do t’i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të APP.

Ndërkohë, po vijon puna për përkthimin e seteve të dokumentave standarte të tenderit, për procedurat e tjera të prokurimit.

Duke ju falënderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

